



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA E DYTË E JASHTËZAKONSHME PLENARE E KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 TETOR 2009

SA DRUGE VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 17. OKTOMBRA 2009. GODINE

Tetor – Oktombar
2009

TRANSKRIPT

NGA SEANCA E DYTË E JASHTËZAKONSHME PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 TETOR 2009

E shtunë, më 17 tetor 2009, ora 13:40

Seancën drejtoi: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuari President Sejdiu,
I nderuari Kryeministër, Thaçi,
Zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar mysafirë,
Të nderuar qytetarë,
I hap punimet e seancës së re të jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, që do të thotë se janë përmbushur kushtet për të filluar punën.

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare, me kërkesë të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendosi që të thërres seancë të re të jashtëzakonshme plenare për:

- **Ratifikimin e Marrëveshjes për demarkacion fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë**

Ftoj Kryeministrin për ta sqaruar konsultimin paraprak.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar President i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,
I nderuar Kryetar i Parlamentit, Jakup Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar të gjithë ju ambasadorë, përfaqësues të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë,
Të nderuar të pranishëm,
Zonja e zotërinj,
Ju falënderoj për mirëkuptimin që treguat për të hyrë edhe në një seancë të jashtëzakonshme të ftuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe nga

unë, si Kryeministër i Republikës së Kosovës, si seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta miratuar Marrëveshjen ndërshtetërore për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që edhe një herë të ritheksoj se në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në zbatim të procesit të paraparë në nenin 3 të Aneksit VIII të Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të Presidentit Ahtisari, gjithashtu dëshiroj të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës dje, me datë 16 tetor 2009, në orët e vona ka nënshkruar Marrëveshjen ndërshtetërore me Republikën e Maqedonisë për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha grupet parlamentare, gjatë tërë periudhës kanë marrë informata shtesë për këtë çështje. Ju morët edhe sqarimet plotësuese ndërkohë dhe besoj se do të reflektohet dhe do të reflektoni në kuptimin më të mirë të vullnetit të mirë dhe të interesit shtetëror. Ju ftoj për votim unanim në interes të shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, Kryeministër!

Radha është e shfave të grupeve parlamentare, nëse e donë fjalën. Mirë, faleminderit, meqë jeni dakord.

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për ratifikimin e Marrëveshjes.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 18, paragrafi 1, Kuvendi i Republikës së Kosovës me vota të 2/3 të të gjithë deputetëve i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare.

Konstatohet se në sallë janë 87 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Lus, ata që nuk kanë kartelë, me ngritje dore të votojnë “për” marrëveshjen.
Faleminderit!

Regjia, sa kanë votuar “për” me ngritjen e dorës?

Meqë pati pengesa teknike, lus regjinë që edhe një herë të përgatitet për votim dhe votojmë tash.

Vazhdojmë, pra, me votimin. Pyes, ata që janë pa kartelë - Kush është për ratifikimin e Marrëveshjes?

Kush është “kundër”? 3 “kundër”.

Kush abstenon?

Konstatohet se me 81 vota “për”, 3 vota “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi ratifikoi Marrëveshjen për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

(Duartrokitje)

Me kështu e përfundojmë seancën e sotme të jashtëzakonshme plenare.

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale